

BULETINI JAVOR

13-17 NËNTOR 2023



Shprehja

"Siguria kibernetike është një përgjegjësi sociale. Të gjithë kemi një rol për të luajtur"

e javës

Përmbajtja:

- Siguria Kibernetike për sektorin financiar.

Siguria Kibernetike për sektorin financiar.

"Në sferën financiare, siguria kibernetike është çelësi për ruajtjen e besimit në çdo transaksion, ku çdo shtresë e enkriptuar mbron integritetin e asetëve tona digjitale."

Në mbarë botën, bankat dhe institucionet financiare janë objekt i shpeshtë i sulmeve kibernetike; siç janë hakerimi i të dhënave të klientëve, vjedhja e identitetit, mashtrimi financiar dhe shfrytëzimi i dobësive në infrastrukturën e tyre të informacionit.

Një sfidë e rëndësishme është mbajtja e të dhënave të ndjeshme nga duart e gabuara. Nga bankat dhe kompanitë e sigurimeve tek firmat e investimeve çdo aspekt i sektorit financiar përballet me kërcënime të rëndësishme kibernetike.




Këshilla sigurie

Zbatoni kontrole të forta sigurie



Menaxhoni rreziqet e palëve të treta

Vlerësoni dhe adresoni vulnerabilitetet



Krijoni një plan reagimi ndaj incidenteve

Përdorni virtual private network



BULETINI JAVOR

13-17 NËNTOR 2023



Shprehja

"Siguria kibernetike është një përgjegjësi sociale. Të gjithë kemi një rol për të luajtur"

e javës

Përmbajtja:

- Serverët MySQL dhe hostet Docker infektohen me DDoS
- Samsung-data breach
- CISA paralajmëron për vulnerabilitete në pajisjet e Juniper të shfrytëzuara në mënyrë aktive
- Microsoft-patching alert



Serverët MySQL dhe hostet Docker infektohen me DDoS

Studiuesit paralajmërojnë se sulmuesit po synojnë serverët MySQL dhe hostet Docker duke instaluar malware të aftë për të nisur sulme DDoS.

Sulmuesit skanojnë internetin për servera MySQL të aksesueshëm publikisht duke përdorur portën TCP 3306 dhe më pas përpiqen t'i komprometojnë ata ose duke përdorur kredenciale të dobëta ose duke shfrytëzuar vulnerabilitetet e njohura.

[Lexo më shumë](#)



CISA paralajmëron për vulnerabilitete në pajisjet e Juniper të shfrytëzuara në mënyrë aktive

Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës (CISA) ka shtuar katër vulnerabilitete sigurie në pajisjet Juniper në katalogun e saj KEV në 13 nëntor 2023, bazuar në shfrytëzimet aktive. Sipas të dhënave të Shadowserver, më shumë se 10,000 pajisje Juniper kanë ndërfaqe të cenueshme të ekspozuara në internet, kryesisht nga Koreja e Jugut dhe përpjekjet për shfrytëzim janë zbuluar që nga 25 gushti 2023.

Agjencive federale u kërkohet të sigurojnë të gjitha pajisjet Juniper në rrjetet e tyre brenda katër ditëve deri më 17 nëntor 2023.

[Link: Lexo më shumë](#)



Samsung-data breach

Samsung Electronics njoftoi së fundmi disa nga klientët e saj për një shkelje të të dhënave që ekspozoi informacionin e tyre personal ndaj një individi të paautorizuar.

Kompania thotë se sulmi kibernetik ka ndikuar vetëm tek klientët që kanë bërë blerje online në Mbretërinë e Bashkuar.

Të dhënat e ekspozuara mund të përfshijnë emra, numra telefoni dhe adresë email. Megjithatë kompania thekson se kredencialet dhe informacionet financiare mbeten të paprekura nga incidenti.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Microsoft-patching alert

Microsoft ka publikuar përditësime sigurie për të adresuar 63 defekte sigurie në software-in e tij për muajin nëntor 2023, duke përfshirë tre vulnerabilitete që janë shfrytëzuar aktivisht.

Nga 63 vulnerabilitetet, tre janë vlerësuar si Kritike, 56 janë vlerësuar të Rëndësishme dhe katër janë vlerësuar si mesatare.

[Link: Lexo më shumë](#)